



Kosova pa Sigurime Shëndetësore DERI KUR?!!...

**Kosova Without Health Insurance
Until When?!!!**



Janar 2011

**Kjo Analizë është përgatitur në bashkëpunim
me Qendrën për Hulumtime Shëndetësore**

PERSONELI:

Ismet KRYEZIU - *Drejtor Ekzekutiv*
Vjollca VOGËL - *Menaxhere e administratës dhe financave*
Leonora CIKAJ - *Asistente për administratë dhe financa*
Arsim GJINOVC I - *IT & design*

5

PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE:

Kreshnik Basha - *Menaxher i programit*
Driton SELMANAJ - *Këshilltar Programi*
Isuf ZEJNA - *Monitorues*
Besnik RAMADANAJ - *Monitorues*
Liridon SELMANI - *Monitorues*
Natyra KASUMAJ - *Monitoruese*

PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE

Naim CAHANAJ - *Koordinator*

PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - *Menaxhere e programit*
Esat MAZREKU - *Koordinator*
Enis XHEMAJLI - *Kryesues i hulumtimit*
Yllka VESELI - *Hulumtuese*

Përmbajtja

6

1. Hyrje
2. Mënyra e gjerëtanishme e financimit të shëndetësisë në Kosovë
3. Rëndësia e krijimit të Fondit dhe Sistemit të Sigurimeve Shëndetësore
4. Odisejada e Projektligjit për Sigurime Shëndetësore
5. Cila është përmbajtja e projektligjit që pret miratimin e Qeverisë së Kosovës?
 - 5.1 Kontribuesit në Sigurime shëndetësore të obligueshëm
 - 5.2 Fondi për Sigurime Shëndetësore
6. Vlerësimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave lidhur me ndikimet që do të sjell miratimi eventual i këtij Ligji
 - 6.1 Ndikimet në Ekonominë e Vendit
 - 6.2 Ndikimet buxhetore
7. Cilat janë vlerësimet e Bankës Botërore përkitazi me ndikimet që do të sjell sigurimet shëndetësore
8. Kosova dhe Rajoni
9. Rekomandimet

1. HYRJE

Pas vitit 1999 Kosova po kalon në një periudhë ndryshimesh të mëdha të sistemit të organizimit shoqëror. Shëndetësia sikur edhe sistemet tjera ka pësuar kolaps si në aspektin organizativ por edhe atë financiar. Derisa në sistemin e kaluar ka ekzistuar sistemi i sigurimit shëndetësor, që nga pas lufta e këtij financimi shëndetësor për shkak të specifikave të veta ka kaluar në financimin e bazuar në taksa.

Analiza e mënyrës së financimit të shëndetësisë në Kosovën e pasluftës flet për kolapsin e sistemit shëndetësor dhe financiar, ku riaktivizimi dhe reforma kanë kaluar në tri faza. Faza e parë ishte periudha emergjente nga vitit 1999-2001 e cila është karakterizuar me ngritjen e një financimi emergjent nga Buxheti i Kosovës dhe donacione të shumta nga organizatat dhe institucionet ndërkombëtare. Faza në zhvillim 2002-2004 dhe faza e konsolidimit 2004 e cila edhe më tutje rezulton me maturimin e financimit bazuar në buxhetin shtetëror dhe taksa. Gjatë kësaj periudhe është tentuar në hulumtimin e metodave të reja për grumbullimin e të ardhurave financiare bazuar në metoda mikse të financimit shëndetësor, megjithatë pa ndonjë rezultat konkret.

Prolongimi i miratimit dhe implementimit të bazës legale për krijimin, dhe funksionalizimin e Fondit si dhe ndërtimin një sistemi të qëndrueshme të Sigurimeve Shëndetësore është dëshmuar që nuk ka qenë në agjendën e klasës politike në Kosovë ku asnjë nga qeveritë që nga pas lufta e deri më sot nuk janë marrë seriozisht me këtë çështje¹.

Mungesa e deri tanishme e Ligjit për Sigurimet Shëndetësore ka krijuar situatën që shërbimet shëndetësore të mos jenë në nivelin e kërkuar si dhe përkrahja materiale për personelin shëndetësorë të jetë shumë larg mesatares së vendeve të rajonit, të cilat e kanë miratuar këtë ligj dhe e kanë në funksion Fondin për Sigurime shëndetësore. Fillimi i operimit të këtij Fondi do të kërkojë personel të kualifikuar, pasi që do të menaxhoj me një shumë të konsiderueshme të mjeteve të qytetarëve të Kosovës.

Ferid Agani njohës i mirë i kësaj problematike vlerëson se Kosova është i vetmi vend në rajon që nuk ka Fond të Sigurimeve Shëndetësore, sistemi është shkatërruar dhe degraduar. Financimi nga buxheti është një formë e vjetër dhe e paqëndrueshëm².

Duke u nisur nga rëndësia e kësaj problematike Instituti Demokratik i Kosovës së bashku me Qendrën për Hulumtime Shëndetësore kanë përgatitur këtë Punim me qëllim ofrimit të të dhënave mbi nevojën e ndërtimit të sistemit të sigurimeve shëndetësore në Kosovë, rëndësinë e ndërtimit të bazës ligjore për krijimin dhe funksionalizimin e Fondit për Sigurimet Shëndetësore si dhe ofrimit të praktikave nga rajoni rreth mënyrave të zgjidhjes së kësaj problematike.

Të dhënat e paraqitura në këtë punim janë të bazuara në dokumentet e institucioneve kompetente të cilat po tentojnë ta rregullojnë këtë segment të shëndetësisë në Kosovë, punimet e ndryshme studimore të përgatitura nga organizatat dhe individë të ndryshëm si dhe në intervistat e realizuara me njerëzit të cilët e njohin mirë apo janë pjesë e procesit të ndërtimit të sistemit të sigurimeve shëndetësore në Kosovë.

¹ Blerim Sylja – Kryetar i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë në Kosovë.

² Intervistë personale, Ferid Agani – Kryetar i Partisë së Drejtësisë.

2. MËNYRA E GJERTANISHME E FINANCIMIT TË SHËNDETËSISË NË KOSOVË

Kosova deri më tani ka pasur një skemë tjetër të financimit të shëndetësisë, jo atë të bazuar në sigurimet shëndetësore. Ky sistem i tanishëm shëndetësor ka të bëjë me atë që shteti i mbledh taksat e përgjithshme, ku e formon buxhetin dhe prej buxhetit i ndan mjetet shëndetësisë. Menjëherë pas luftës mbështetja financiare për shëndetësinë nga institucionet qendrore ishte në nivelin 20 për qind, ndërsa tani rreth 6-7 për qind³.

Sektori shëndetësor në Kosovë mbetet i financuar nga tatimet, ndërsa burimet private vlerësohet të kontribuojnë me rreth 40 për qind të shpenzimeve të përgjithshme për shëndetësi⁴.

Nga shuma vjetore e parave që ndahet nga buxheti i shtetit për shëndetësinë në Kosovë, spitalet shpenzojnë rreth 51 % të atyre mjeteve, komunat – 26 % dhe Ministria e Shëndetësisë për shërbime të tjera shpenzon rreth 22 %. Duhet sqaruar se vetëm gjysma e shpenzimeve të përgjithshme në shëndetësi mbulohet nga buxheti i qeverisë ndërsa gjysma tjetër mbulohet nga xhepi i pacientëve në vendin e kryerjes së shërbimit. Në vitin 2004, është vlerësuar se për shëndetin e një banori në Kosovë janë shpenzuar 81 euro⁵.

Tabela 1. Shpenzimet e Qeverisë për shëndetësi

Kosovë	2004	2005	2006	2007
Shpenzimet e qeverisë për shëndetësi (Euro, milionë)	64.9	71.4	68.3	70.1
Shpenzimet e qeverisë për shëndetësi (%, BPV-së)	2.8 %	3.2 %	3.0 %	3.1 %
Shpenzimet e qeverisë për shëndetësi (% e shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë)	10.4	9.6	9.8	9.8

Burimi: MEF

Institucionet e kujdesit shëndetësor në sektorin publik janë në pronësi të shtetit. Financimi dhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor është i integruar dhe i menaxhuar nga entiteti i njëjtë, gjegjësisht nga Qeveria e Kosovës. Pagesat për kujdesin sekondar dhe terciar realizohen përmes sistemit të menaxhimit financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF). Për kujdesin primar shëndetësor, MEF-i ua bart komunave grantet shëndetësore në bazë të sistemit për kokë banori. Planifikimi financiar bëhet në nivelin qendror (MSh dhe MEF).

³ Intervistë personale, Ilir Tolaj – Sekretar permanent në Ministrinë e Shëndetësisë

⁴ Studim i Bankës Botërore “Kosovo Health Financing Reform Study” 6 maj 2008

⁵ Raport i rezultateve - Analizë krahasimore e skemave të sigurimit shëndetësor në Evropën Juglindore, 29 qershor 2009.

3. RËNDËSIA E KRIJIMIT TË FONDIT DHE SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

Rregullimi ligjor i financimit të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm të sektorit shëndetësor si dhe krijimi i Fondit për sigurime shëndetësore, duke përfshirë dhe bazën ligjore të sistemit të sigurimeve shëndetësore të banorëve të Republikës së Kosovës, janë elemente bazike në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të qytetarëve dhe institucioneve për mbrojtjen dhe kujdesin shëndetësor, rehabilitimin dhe mbrojtjen financiar nga shpenzimet për kujdes shëndetësor themelor.

Me krijimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore do të ndërrohet rrënjësisht sistemi shëndetësor dhe shërbimet do të jenë më të mira ndaj atyre që e bëjnë pagesën e tij. Një mundësi e tillë ju ofrohet edhe institucioneve private, normalisht nëse është arritur paraprakisht një marrëveshje e tillë⁶.

Në esencë ajo që duhet gjithsesi të sigurohet është që shërbimet pa pagesë të garantohen për qytetarët nën asistencë, të varfëritë, të pa aftit, të gjithë ata që nuk kanë mundësi të ekonomizojnë si pensionistet, invalidët etj, ata duhet të marrin shërbime pa pagesë, dhe tërë buxheti i shëndetësisë duhet të shkoj për këtë kategori⁷.

Genc Demjaha ekspert i menaxhmentit shëndetësor rekomandon që para krijimit të Fondit për sigurime shëndetësore duhet krijuar sistemin informimit shëndetësor (S.I.SH) dhe Sistemin e informimit të menaxhmentit shëndetësor (S.I.M.SH) në të gjitha institucionet. Administrimi i Fondit kërkon ekspert të kësaj fushe, të cilët Kosova nuk i posedon dhe krijimi i tyre ka koston e vet. Po ashtu vetë krijimi i një fondi të veçantë për shëndetësi krijon tensione në strukturat vendimmarrëse sa i përket kontrollit mbi të shton më tej z.Demjaha⁸.

Megjithatë përkundër të gjitha vështirësive dhe sfidave eventuale, hapi më i rëndësishëm do të ishte përgatitja e bazës legislative për Fondin e sigurimeve shëndetësore. Dokumentet ligjore duhet t'i përkufizojnë mandatet dhe përgjegjësitë specifike të organizatës dhe mënyrën e mbikëqyrjes së institucionit⁹. Po ashtu duhet parashikohet që organizimi dhe menaxhimi i Fondit për sigurime shëndetësore kërkon një kohë para-përgatitjeje me mjete teknike dhe administratë kompetente. Sa për ilustrim vendeve si: Estonia, Kirgistani e Kroacia, nga aprovimi i Ligjit për sigurime deri në fillimin e implementimit në praktik iu deshën 2 deri 6 vite.

⁶ Intervistë personale, Sadik Idriz- ish kryetar i Komisionit parlamentar për Shëndetësi

⁷ Intervistë personale, Ferid Agani – Kryetar i Partisë së Drejtësisë

⁸ Intervistë personale, Genc Demjaha ekspert i menaxhmentit shëndetësor

⁹ Studim për Sigurimi Shëndetësor - Raport i rezultateve - Analizë krahasimore e skemave të sigurimit shëndetësor në Evropën Juglindore, 29 qershor 2009. f.25

4. ODISEJADA E PROJEKTLIGJIT PËR SIGURIME SHËNDETËSORE

Të gjitha qeveritë e pasluftës kanë tentuar reformimin e financimit shëndetësor, por pa ndonjë sukses. Ligji i Shëndetësisë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2004, ofronte bazë për këtë reformë. Ky ligj në përmbajtjen e tij propozonte formimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore. Sigurimi shëndetësor themelor ishte përcaktuar si sigurim i detyrueshëm për të gjithë qytetarët në marrëdhënie formale të punës, si dhe për personat fizikë dhe personat juridikë. Fatkeqësisht nenet që rregullonin këtë çështje nuk u implementuan asnjëherë deri më tani.

Strategjia shëndetësore 2005-2015 ishte një dokument tjetër që pretendonte të ofrojë një udhërrëfyes për këtë reformë. Gjatë viti 2004 draft-ligji për Sigurime Shëndetësore është diskutuar dhe ka filluar së draftuari. Ky draft ligj ka parashikuar që 60% e ardhurave për Fondin për Sigurime Shëndetësore do paguhej nga buxheti i konsoliduar, 13.5 % do vinin nga kontributet përmes tatimeve në pagë, 21% do alokeshin nga pagesat direkte të pacienteve ndërsa 6.5 % nga bashkëpagesat e pacientëve. Tre vjet më vonë në prill të vitit 2007, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Sigurime Shëndetësore ku financimi shëndetësor do bëhej kryesisht nga tatimet në pagë. Mirëpo fatkeqësisht ky Ligji nuk u nënshkrua nga PSSP-ja dhe si i tillë është rikthyer për rishikim, e që në fakt nënkuptonte, nisjen e punimit të tij nga fillimi.

Rishqyrtimi i hollësishëm konkludoi se potenciali financiar i sigurimeve shëndetësore në Kosovë ishte modest. Duke marre parasysh që tatimi në pagë kur kemi një financim shëndetësor kryesisht nga sigurimet është rreth 13% dhe 2-4% kur sigurimet janë financim miks atëherë del se në bazë të numrit të të punësuarve në Kosovë dhe pages mesatare të tyre nuk mbulohej as për së afërmi kërkesat dhe nevojat e sistemit shëndetësor dhe pacientëve. Kjo për shkak se sektori formal i punësimit është i vogël, prandaj u kërkua gjetja e formave alternative të financimit.

Po ashtu mungesa e kapaciteteve organizative dhe institucionale vështirëson menaxhimin e fondit të sigurimit shëndetësor. Kalimi nga grumbullimi qendror tati-mor i të ardhurave në një agjenci të pavarur të sigurimeve në disa vende ka krijuar tensione të dukshme të qendrat politike vendimmarrëse rreth administrimit të saj.

Gjatë vitit 2009-2010 Ministria e Shëndetësisë i kishte vënë detyrë vetes që ta draftojë edhe njëherë këtë projektligj dhe pas disa muajsh pune dhe konsultimesh të ndryshme, ky projektligj është proceduar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovës, e cila për shkak të rrethanave politike të krijuara në vend e sidomos pas shpërndarjes së Kuvendit, Qeveria këtë Projektligj edhe më tutje vazhdon ta mbajë në sirtarët e saj.

5. CILA ËSHTË PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT QË PRET MIRATIMIN E QEVERISË SË KOSOVËS?

Hartuesit e këtij Projektligji (Ministria e Shëndetësisë) kanë shpjeguar qëllimin dhe arsyen e përgatitjes së tij, duke pretenduar që përmes këtij projektligji do të rregullohej sistemi i sigurimit shëndetësor për banorët e Republikës së Kosovës, të drejtat dhe obligimet dhe mënyrën e zbatimit të sigurimit shëndetësor. Me këtë projektligj parashihet themelimi, organizimi, funksionimi si dhe mënyra e financimit të sigurimit shëndetësor.

Sipas këtij projektligji sigurimi shëndetësor në Republikën e Kosovës, do të organizohet dhe zbatohet si sigurim shëndetësor i obligueshëm dhe vullnetar, ku sigurimi shëndetësor i obligueshëm është i detyrueshëm për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës. Të drejtat nga sigurimi i detyrueshëm janë: E drejta për kujdes shëndetësor themelor dhe e drejta për kompensim material për shkak të paaftësisë së përkohshme për punë.

Neni 8 i këtij Projektligji ka përcaktuar që sigurimin shëndetësor të obligueshëm e zbaton Fondi për sigurime shëndetësore i Republikës së Kosovës¹⁰.

Përpos sigurimeve shëndetësore të obligueshme janë paraparë edhe sigurimet shëndetësore vullnetare të cilat konsiderohen sigurime shëndetësore plotësuese, që zbatohen për shërbimet të cilat nuk përfshihen në kujdesin shëndetësor themelor dhe të cilat zbatohen nga ana e Fondit dhe Organizatave private.

5.1 Kontribuesit në Sigurime shëndetësore të obligueshëm

Në këtë projektligj janë përcaktuar qartë edhe se nga mund të mblidhen mjetet financiare për sigurimin shëndetësor të obligueshëm. Burimet janë parashikuar që të jenë:

- Kontributet nga të ardhurat personale dhe kompensimet për të ardhurat personale të të punësuarve dhe punëdhënësve;
- Kontributet nga të ardhurat e personave të cilët kryejnë veprimtari të pavarur;
- Kontributet nga pensionet;
- Kontributet për të papunësuarit;
- Mjetet nga obliguesit e tjerë për kontribute;
- Bashkëpagesat e personave të siguruar;
- Buxheti i Republikës së Kosovës;
- Përqindja e te hyrave nga taksa e akcizës në alkool, duhan, naftë dhe derivate;
- Pagesat nga shtetet (Fondet) tjera sipas marrëveshjeve ndërshtetërore;
- Dividendët, kamatat, dhuratat dhe trashëgimitë;
- Donacionet;
- Burimet e tjera¹¹.

¹⁰ Neni 8 i Projektligjit për Sigurime Shëndetësore.

¹¹ Neni 34 i Projektligjit për Sigurime Shëndetësore.

5.2 Fondi për Sigurime Shëndetësore

Me qëllim që të funksionalizohet dhe të ndërtohet një sistem i Sigurimeve shëndetësore, sponzorizuesi i këtij Projektligji ka paraparë që Ministria e Shëndetësisë, në afat prej gjashtë muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, duhet të themelojë Këshillin Përgatitor për themelimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore.

Fondi për Sigurime Shëndetësore do të kishte për obligim që të zbatoj politikat e zhvillimit dhe të përparimit të kujdesit shëndetësor, të siguroj parimet e realizimit të të drejtave të siguruarve dhe kujdeset për realizimin e këtyre të drejtave, të ofroj shërbime profesionale për realizimin e të drejtave nga sigurimi shëndetësor i obligueshëm; të planifikoj mjetet për sigurimin shëndetësor të obligueshëm etj.

Tek dispozitat kalimtare të këtij projektligji është përcaktuar se nga kush duhet të financohet sektori shëndetësor publik deri në fillimin e punës së Fondit. Sipas këtij projektligji kjo duhet të financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës, me këtë përpjesëtim:

- 10 % e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, të shpenzuar vjetor, për shëndetin parandalues, dytësor dhe tretësor;
- Buxheti i shëndetësisë komunale për Kujdesin parësor shëndetësor;
- Përqindja e tatimit për alkool dhe duhan, sipas rregulloreve përkatëse;
- Pagesat nga shtetet (Fondet) tjera sipas marrëveshjeve ndërshtetërore;
- Bashkëpagesat e personave të siguruar;
- Dividendat, kamatat, dhuratat dhe trashëgimitë;
- Donacionet;
- Burimet e tjera¹².

6. VLERËSIMET E MINISTRISË SË EKONOMISË DHE FINANCVE LIDHUR ME NDIKIMET QË DO TË SJELL MIRATIMI EVENTUAL I KËTJË LIGJI

Në dokumentin e përgatitur nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të datës 16 shkurt 2010 për Vlerësimin e Ndikimit buxhetor të projektligjit për Sigurime Shëndetësore, shprehen hezitime dhe rezerva mbi shkallën e lartë të pasigurisë dhe qëndrueshmërisë financiare, edhe për vetë faktin se projektligji është sa kompleks aq edhe gjithëpërfshirës¹³.

6.1 Ndikimet në Ekonominë e Vendit

Zyrtarët e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave kanë dhënë vlerësimet e tyre edhe për ndikimin e këtij projektligji në ekonominë e vendit. Sipas tyre nevojitet një qasje shumë e kujdesshme meqë efektet e futjes në sistem të këtij ligji do të jenë prezent në shumë fusha të ekonomisë. Niveli i papunësisë në Kosovës në shkallën 40% është prob-

¹² Neni 58 i Projektligjit për Sigurime Shëndetësore.

¹³ Dokument i MEF-it (Verifikimi / Ndryshimi i Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor në Buxhetin e Kosovës në Projektligjin për Sigurime Shëndetësore) 16 shkurt 2010.

lem serioz sepse mbledhja e kontributeve shëndetësore nga të punësuarit aktiv, nuk do të mund të siguronte qëndrueshmërinë e Fondit që më pas do të shtronte nevojën për mbështetje nga Buxheti i Kosovës. Ky projektligj sipas MEF-it mund të ketë edhe efekte negative në tregun e punës, duke inkurajuar punësimin joformal. Futja në sistem e këtij ligji vlerësohet po ashtu se mund të ketë efekte direkte të zvogëlimin e potencialit investues, për faktin që një pjesë e kontributeve (5%) duhet të paguhet nga ana e punëdhënësit¹⁴.

6.2 Ndikimet buxhetore

Sipas dispozitave të këtij Projektligji implementimi dhe funksionalizimi i Sigurimeve Shëndetësore kalon përmes dy fazave: faza e parë (faza e tranzicionit) ku financimi në një përqindje të caktuar duhet të jetë nga Buxheti i Kosovës si dhe nga burimet tjera. Gjatë kësaj faze Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Ekonomisë dhe e Financave obligohen të përgatisin infrastrukturën ligjore dhe kushtet tjera për fillimin e punës së Fondit. E tëra kjo duhet të merr një afat prej tre vjetësh. Ndërsa faza e dytë parasheh që Sigurimin shëndetësor të obligueshëm ta zbatoj Fondi.

7. CILAT JANË VLERËSIMET E BANKËS BOTËRORE PËRKITAZI ME NDIKIMET QË DO TË SJELLIN SIGURIMET SHËNDETËSORE?

Në studimin e Bankës Botërore, sigurimi shëndetësor social përmes tatimeve në paga është treguar si i papërshtatshëm edhe pse qeveria e Kosovës ka insistuar në atë opsjon. Çështja kryesore lidhur me këtë është se baza e të hyrave sipas sigurimit të financuar nga tatimi në paga është e kufizuar në një sektor të vogël formal dhe me mundësi të niveleve të larta të shmangies së kontributeve. Kosova ka një sektor shumë të vogël formal. Shmangja e pagesës së kontributeve pritet të jetë e lartë në Kosovë, që do të thotë se sigurimi shëndetësor social i financuar nga tatimet në paga ka shumë gjasa të mos rezultojë në të hyra shtesë për sektorin shëndetësor¹⁵.

Studimi i Bankës Botërore, ka sugjeruar forma tjera shtesë të cilat do të ndikonin në rritjen e buxhetit për financimin e sistemit të kujdesit shëndetësor siç janë tatimet për ruajtjen e shëndetit nga duhani¹⁶.

Sigurimi privat gjithashtu është përmendur si një nga opsionet, por nuk ka qenë ndonjë alternativë strategjike për Kosovën. Në rastin e Kosovës, sigurimi privat do të ishte vështirë të zbatohet për shkak të mungesës së kapaciteteve institucionale dhe rregullative¹⁷.

¹⁴ Dokument i MEF-it (Verifikimi / Ndryshimi i Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor në Buxhetin e Kosovës në Projektligjin për Sigurime Shëndetësore) 16 shkurt 2010. .

¹⁵ Studim për Sigurimi Shëndetësor - Raport i rezultateve - Analizë krahasimore e skemave të sigurimit shëndetësor në Evropën Juglindore, 29 qershor 2009. f.27

¹⁶ Studim i Bankës Botërore "Kosovo Health Financing Reform Study" 6 maj 2008

¹⁷ Studim për Sigurimi Shëndetësor - Raport i rezultateve - Analizë krahasimore e skemave të sigurimit shëndetësor në Evropën Juglindore, 29 qershor 2009. f.27

Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, 29 % e popullsisë të moshës së punës janë të punësuar në sektorin formal. Zbatimi i sigurimit shëndetësor social me siguri do të rezultonte me shmangien e pagesës së kontributeve (rreth 50% për bizneset dhe rreth 80% për bujqit), që rrjedhimisht do të çonte në të hyra dukshëm më të vogla të grumbulluara për sektorin shëndetësor¹⁸.

Banka botërore ka bërë një skenar ku nëse tatimi në pagë do ishte 10% sa do të mbushej arka e fondit të sigurimeve shëndetësore e krahasuar pa dhe me evazion fiskal dhe gjendja është si më poshtë e shprehur në milion¹⁹.

Tabela 2. Shkalla e kontributit 10% dhe të ardhurat për sigurime shëndetësore sipas gjendjes ekonomike të vitit 2004

	Sektori publik	Sektori privat	Sektori i bujqësisë	Totalisht
Tatimet në pagë	10%	10%	10%	10%
Të ardhurat e pritura	16.256.250	89.994.600	4.889.880	111.140.730
Shkalla e evazionit	0%	50%	80%	
Të ardhurat e mundshme	16.256.250	44.997.300	977.976	62.231.526

Burimi: World Bank, 2008

Në bazë të tabelës së mësipërme mund të shohim se shkalla e evazionit fiskal 50% për sektorin privat dhe 80 % për sektorin e bujqësisë, që mendohet që është shkalla e rëndomtë në rajon, (World Bank,2008) atëherë del se grumbullimi i të ardhurave të planifikuara për shëndetësi vështirësohet. Kjo tregon për brishtësinë e sistemit të grumbullimit të taksave në rajon dhe në Kosovë gjë që tregon për vështirësitë e rritjes së financimit për shëndetësi përmes tatimeve në pagë për shkak të tendencës së ikjes së pagesës së tatimeve dhe rritjes së punësimit dhe ekonomisë informale.

¹⁸ Studim për Sigurimi Shëndetësor - Raport i rezultateve - Analizë krahasimore e skemave të sigurimit shëndetësor në Evropën Juglindore, 29 qershor 2009. f.27

¹⁹ Kosovo Health Financing Reform Study. World Bank ,2008

8. KOSOVA DHE RAJONI

Derisa shtetet fqinja po vazhdojnë me konsolidimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore, sistemi shëndetësor i Kosovës edhe tani vazhdon të financohet 100 % nga shteti dhe pagesat direkte nga xhepi.

Tabela 3. Niveli i shpenzimeve publike buxhetore dhe me sigurime për shëndetësi në disa vende të rajonit, 2005

Shteti	Sigurime shëndetësore	Buxheti shtetëror	Total %
Shqipëria	24.8	75.2	100
Bosnja e Hercegovina	96.5	4.4	100
Maqedonia	96.1	3.9	100
Kroacia	88.3	11.7	100
Kosova	0	100	100
Sllovenia	91.4	8.6	100
Serbia	75.7	24.3	100

Burimi: Banka botërore

Shikuar nga tabela e mësipërme del se vetëm Kosova në rajon ka ngelur në financimin e shëndetësisë në masën 100 % nga buxheti shtetëror dhe pagesat direkte nga qytetarët gjatë kryerjes së shërbimeve mjekësore, derisa të gjitha shtetet e rajonit kanë avancuar me sistemin e sigurimeve shëndetësore.

Tani për tani Kosova sa i përket financimit shëndetësor ka sistemin më të lehtë për tu administruar i cili është i bazuar kryesisht në taksa dhe pjesërisht nga participimet e qytetarëve. Mbulimi i popullatës me shërbime shëndetësore në këtë sistem është uniform. Por financimi mbetet shumë i ulët pavarësisht mënyrës së pagesës. Vetëm 81 Euro/capita/vit është shuma e harxhuar për shëndetin e një banori në Kosovë. Nga kjo shumë 45 Euro janë shpenzuar nga buxheti qeveritar, 4 Euro nga donatorët ndërsa 32 euro janë shpenzimet nga xhepi i vetë qytetarëve të Kosovës. Niveli i financimit të shëndetësisë bazuar në nivelin e GDP mund të krahasohet me shtetet tjera ku te ne arrin në shkallën 8.3% (Eorld Bank Poverty Assessment 2005) bazuar edhe në të dhënat e MEF-it. Por nëse bazohemi në faktin se vetëm 81 euro për kokë banori harxhohen në vit për shëndetësinë, derisa në rajon është me qindra ndërsa në shtete evropiane është më mijëra euro, atëherë mund të konkludojmë se shëndetësia në Kosovë është me financim më të ulët në Evropë.

Megjithatë është i vërtet fakti se vendet me një rritje minimale ekonomike me një papunësi të lartë me një GDP të ulët si e jona, edhe pse kanë filluar me sigurime shëndetësore vazhduan të financojnë sistemin shëndetësor nga taksat dhe patën një prirje të rritjes së participimit direkt të pacientëve. Vendet që kanë pasur sukses me sigurime shëndetësore si: Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Sllovakia dhe Sllovenia, janë vendet me GDP të lartë dhe punësim të lart formal ku sigurimet arrijnë ti mbulo-

jnë deri 90% të shpenzimeve totale për shëndetësinë.

Bazuar në praktikat e vendeve të rajonit gjatë implementimit në praktikë të sigurimeve shëndetësore janë nxjerrur disa mësimet të cilat do të mund të ishin të dobishme për Kosovën:

- Kosova që të mos jetë tepër ambicioze me gamën e mbulimit shërbimeve bazike shëndetësore pasi që kjo mund të jetë barrë shumë e rëndë për Fondin e Sigurimeve shëndetësore.

- Kosova me qëllim të ndërtimit dhe zbatimit efektiv të politikave shëndetësore, të sigurimit shëndetësor dhe të menaxhimit financiar, mund të kërkojë kredi të buta nga organizmat ndërkombëtar financiar. Një shembull të tillë e ka ndjekur Maqedonia e cila ka marrë një kredi specifike për ngritjen e kapaciteteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Fondit për sigurime shëndetësore

- Reformat në fushën e pagesave do të kenë nevojë për kohë, siç ishte rasti edhe me vendet fqinje. Në mënyrë që kjo të funksionojë, zhvillimi i infrastrukturës për grumbullimin e të dhënave dhe ngritjes së Sistemit informative shëndetësor²⁰.

- Të gjitha shtetet e rajonit kanë zbatuar një shkallë të financimit të përzier së bashku me tatimin në paga për plotësimin e financimit në shëndetësi²¹. Shembullin e njëjtë preferohet ta ndjekë edhe vendi ynë.

²⁰ Studim për Sigurimi Shëndetësor - Raport i rezultateve - Analizë krahasimore e skemave të sigurimit shëndetësor në Evropën Juglindore, 29 qershor 2009. f.28

²¹ Studim për Sigurimi Shëndetësor - Raport i rezultateve - Analizë krahasimore e skemave të sigurimit shëndetësor në Evropën Juglindore, 29 qershor 2009. f.28

9. REKOMANDIME:

- Qeveria e Kosovës duhet të ketë vizion të qartë rreth asaj se çfarë sigurimi shëndetësor do ishte më i përshtatshëm si në aspektin organizativ dhe financiar. Do duhej shikuar se çfarë implikimesh mund të ketë në sistemin shëndetësor dhe sektorët tjerë si tregu i punës, sektori privat dhe ekonominë familjare.
- Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet të miratojnë bazën ligjore për Fondin e sigurimeve shëndetësore, dhe të përkufizojnë mandatet dhe përgjegjësitë specifike të organizatës dhe mënyrën e mbikëqyrjes së institucionit.
- Aspekti ligjor i financimit të shëndetësisë në Kosovë nuk ka nevojë të vuloset me ligjin e parë për sigurimin shëndetësor. Procesi i krijimit të mjedisit ligjor për sigurimin shëndetësor ka nevojë të jetë i vazhdueshëm dhe i hapur ndaj përvojave që do të fitohen gjatë procesit.
- Duke u bazuar në rrethanat e veçanta që ka Kosova aplikimi i sistemit të kombinuar të financimit shëndetësor do ishte më i qëndrueshmi. Ideja se sigurimi shëndetësor do mund të mbulonte tërë shpenzimet shëndetësore duhet braktisur në këtë kontekst ekonomik që vepron Kosova.
- Përdorimi i burimeve tjera financiare përmes taksave direkte dhe indirekte në disa produkte si duhani, alkooli të destinuara kryesisht për shëndetësinë mund të shërbenin si burime shtesë për rritjen e financimit.
- Modeli i funksionimit të Trustit Pensional të Kursime si Agjenci e pavarur, mund të shfrytëzohej si model për sistemin e ardhshëm të sigurimit shëndetësor.
- Qartësimi në detaje i pakos së shërbimeve që mund të mbuloj sigurimi eventual dhe studimi i hollësishëm i kostos së secilit shërbim shëndetësor duhet kryer paraprakisht në mënyrë që qartësohet se sa mbulim financiar mund të ofrojë sigurimi shëndetësor.
- Të bëhet ristrukturimi i sistemit të ofrimit të kujdesit shëndetësor, duke shkuar kah ndarja blerës-ofrues që i jep mëvetësi të rritur institucioneve shëndetësore dhe e fuqizon rolin mbikëqyrës të qeverisë.
- Parapërgatitja me kohë e infrastrukturës profesionale – menaxheriale dhe teknike do lehtësonte fillimin e suksesshëm të funksionalizimit të Fondit të sigurimeve shëndetësore .

Content

18

1. Intro
2. Current situation of the health insurance in Kosova
3. Importance for establishment of the Fund and health insurance system
4. Wayfaring of the Draft Law on Health Insurance
5. What is the content of the draft law that awaits endorsement of the Government of Kosova?
 - 5.1 Obligated contributing parties in health insurance
 - 5.2 Funds for Health Insurance
6. Evaluation of the Ministry for Economy and Finances concerning the impact made by endorsement of this Law
 - 6.1 Impact on the economy of the country
 - 6.2 Budgetary impact
7. Evaluation of the World Bank concerning the impact that would make law on health insurance
